



VENDIM

Nr. 52, Datë 06.04.2017

**MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT NR. 190 DATË 22.12.2016, TË
BORDIT TË ERE-S, DERI NË 31.12.2017**

Në mbështetje të neneve 10 pika 2, 16, 20 gërma “c”, neni 83, 85 dhe 109 pika 5 të ligjit nr.43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, VKM Nr. 244 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrjnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” nenit 22 të Rregullores së organizimit, funksionimit dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr.96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 06.04.2017, pasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike si dhe rekomandimet e MEI-t për shtyrjen e afatit të tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike të miratuara,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. Nr. 191, datë 22.12.2016 ka vendosur mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të OST sh.a. për përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2017;
- Bordi i ERE-s me vendimin 192, datë 22.12.2016 ka vendosur mbi fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifave për çdo nivel tensioni për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2017;
- Bordi i ERE-s me iniciativën e vet, me vendimin Nr. 31 datë 20.02.2017 është shprehur për përcaktimin e tarifës së shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike aksionet e së cilës zotërohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, KESH sh.a. për periudhën 1 prill 2017 – 31 dhjetor 2017.

- Bordi i ERE-s me iniciativën e vet, me vendimin Nr. 32 datë 20.02.2017 , është shprehur për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për periudhën 1 prill 2017 – 31 dhjetor 2017.

Në zbatim të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s" përgjatë procesit të shqyrtimit të këtyre aplikimeve janë kryer veprimet e mëposhtme proceduriale.

- Publikimi i aplikimit në faqen zyrtare të ERE-s brenda afatit që përcakton rregullorja duke i kërkuar zyrtarisht edhe shoqërisë OSHEE sh.a dhe OST sh.a të zbatojnë detyrimin për të bërë publikimin nga ana e tyre të aplikimeve respektive
- Njoftimi i palëve të interesuara me shkresën nr 265 prot. Datë 30.03.2017 për zhvillim seance dëgjimore në lidhje me rishikimin e tarifave të përdorimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2017 në kuadër të aplikimit përkatës të OSHEE.
- Analiza e informacioneve të marra në lidhje me të ardhurat e kërkuara nga ana e shoqërive.
- Analiza ka konsistuar në krahasimin e të ardhurave të kërkuara, të miratuara nga Bordi i ERE-s për vitin 2015 dhe atyre faktike për të njëjtën periudhë, shpenzimet faktike të viti 2016 si dhe ato të pritshme për vitin 2017 sipas aplikimeve dhe informacioneve shtesë.
- Nga këto analiza dhe vlerësime të përgjithshme rezulton se, shoqëritë KESH sh.a., OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. kanë performancë të kënaqshme e përgjithësisht kanë mbuluar kostot e veprimtarive të këtyre aktiviteteve përgjatë periudhës 2015-2016 si dhe kanë krijuar një rezervë për zhvillimin normal të aktiviteteve të licensuara dhe përmirësimin e mëtejshëm të performancës në operim.
- Shkresa e MEI me Nr. 682/2, datë 03.04.2017, në cilësinë e institucionit përgjegjës për hartimin e politikave të sektorit, me të cilin ERE bashkëpunon në zbatim edhe të parashikimeve të nenit 10 pika 2 të ligjit nr. 43/2015 "Per sektorin e energjise elektrike" vlerëson mbajtjen e të njëjtit rregjim tarifar për vitin 2017 për të tre kompanitë për arsyt:
 - *Ministria e Energjisë dhe Industrisë është drejt përfundimit të procesit për bërjen efektive të Marrëveshjes së Huasë mes KESH sh.a. dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për Projektin "Shqipëria, Plani i Ristrukturimit të KESH", Marrëveshja e Garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave*

dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, në mënyrë që të garantojë përmbushjen e kushteve financiare të parashikuara, me qëllim që të shmangen kostot financiare shtesë.

- *Nga ana e MEI –t gjithashtu në bashkëpunim me Banken Botërore, po përmbillet procesi i rishikimi të Planit të Rimëkëmbies së Sektorit të Energjisë Elektrike dhe problematika e marrëdhënieve të ndërsjella të kompanive, masa të cilat do të pasqyronin më qartë situatën e përmirësuar financiare të sektorit dhe do të reflektonin në mënyrë transparente rezultatet e reformave të kryera në përputhje me kriteret që përcakton ligji dhe objektivat e cituara më sipër. Nevoja për investime mbetet akoma një imperative për sistemin në përgjithësi dhe atë të shpërndarjes në veçanti. Ndërkaq, prej një viti sistemi nuk merr më mbështetje nga buxheti i shtetit por kontribuon në të duke shlyer të gjitha detyrimet. Rishikimi i planit synon të përmirësojë treguesit target dhe të rrisë në një nivel cilësor më të lartë performancën.*
- *Në përfundim, mbajtja e sistemit tarifor do mbështesë sektorin energjitik nëpërmjet qëndrueshmërisë financiare.*
- Me vendimin 194 datë 30.12.2016 Bordi I ERE ka vendosur në pikën 2 : Deri në miratimin e tarifës së Transmetimit të energjisë elektrike për të cilën kanë filluar procedurat me Vendimin e Bordit të ERE-s nr.191, datë 22.12.2016, për qëllime të prokurimit të humbjeve në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, OST sh.a të sigurojë humbjet nga KESH sh.a. në përputhje me përcaktimet e Kontratës për shit-blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit, miratuar me Vendimin Nr. 78, datë 07.06.2016 të Bordit të ERE.
- ERE për gjithë sa më sipër, gjykon të mos përcaktojë tarifa të reja për vitin 2017, përfshirë edhe tarifën për shërbimin e transmetimit procedura për shqyrtimin e së cilës ka filluar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 191, datë 22.12.2016
- Me përcaktimin e tarifave dhe çmimeve për periudhën e mbetur të vitit 2017, mbyllet procedurat e nisura me vendimet Nr. 191 dhe Nr. 192 datë 22.12.2016

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1.Shtyrjen deri në 31.12.2017 të fuqisë juridike të vendimit Nr. 190 datë 22.12.2016, të Bordit të ERE për lënien në fuqi të tarifave dhe çmimeve të përkohëshme të energjisë elektrike të miratuara me Vendimet Nr .139, Nr. 145, Nr.146, Nr.147, dhe Nr.148 datë 26.12.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE-S,

2. Fuqia Juridike e Vendimit Nr.13, datë 16.02.2016 “Mbi tarifën fikse të energjisë elektrike, që do t`u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike, nga hidrocentralet për vitin 2016”, sipas pikës 1 të vendimit Nr.190 datë 22.12.2016, të Bordit të ERE, shteron me marrjen e vendimit për përcaktimin e tarifës fikse të energjisë elektrike, që do t`u paguhet prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet për vitin 2017 në zbatim të ligjit nr.7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

3. Për qëllime të prokurimit të humbjeve në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike, OST sh.a të vijojë të sigurojë humbjet nga KESH sh.a. në përputhje me përcaktimet e Kontratës për shit-blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit, miratuar me Vendimin Nr. 78, datë 07.06.2016 të Bordit të ERE deri në afatin e parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a., OST sh.a., Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Autoritetin e Konkurrencës si dhe të interesuarit për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.